



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:035443

Datë: 12.07.2024

Numri i dokumentit: 05934629

C.nr.110/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V.B nga Fushë Kosova, të cilën e sipas autorizimit përfaqëson avokatja B.Xh nga Malisheva, ndaj të paditurit R (R) H nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, me objekt të kontestit – mos përmbushja e kontratës dhe kthimi i mjeteve, vlera e kontestit 11,000.00 euro, jashtë seancës, më datën 12.07.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET POSHTË si e palejueshme padia e paditëses V.B nga Fushë Kosova, ndaj të paditurit R (R) H në këtë çështje juridike dhe anulohen të gjitha veprimet procedurale të kryera nga gjykata.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja V.B nga Fushë Kosova, përmes përfaqësueses të saj të autorizuar, më datën 22.02.2022 në këtë gjykatë ka parashtruar padinë kundër të paditurit R (R) H nga fshati Dejnë, Komuna e Rahovecit, me objekt të kontestit – mos përmbushja e kontratës dhe kthimi i mjeteve, vlera e kontestit 11,000.00 euro.

Gjatë shqyrtimit paraprak të padisë gjykata gjeti gjykatat vendore nuk kanë juridiksion për të vendosur në këtë çështje juridike kontestimore.

Në nenin 18.3 të LPK-së parashihet që: *“Kur gjykata gjatë zhvillimit të procedurës konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata e vendit, do të shpallet inkompetente, do t’i anulojë veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë. Mirëpo, gjykata nuk do të veprojë ashtu nëse kompetenca e gjykatës së vendit tonë varet nga pëlqimi i të paditurit, e i padituri e ka dhënë pëlqimin e vet”*

Në kontratën për ndërtimin, e cila gjendet në shkresat e lëndës, e lidhur me datën 14.08.2012 në zyrën noteriale në Lezhë, ndërmjet porositëses Violeta Berisha, në rastin konkret paditëse, garantuesit R.H, në rastin konkret i paditur, dhe sipërmarrësit “N me qendër në Lezhë, është

përcaktuar se “Çdo konflikt që mundë të lind për shkak të kësaj kontrate dhe në rast se zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tij është Gjykata e Rrethit. Përveç kësaj, kontrata në fjalë lidhet me paluajtshmërinë që gjendet jashtë juridiksionit të gjykatave vendore.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike dhe dispozitës së lartcekur si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18.3 dhe 392 pika a) të LPK-së, është vendosur sikur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.110/2022, me datë 12.07.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.